



Datë: 17.03.2025  
Numër Protokolli: 1824/2025

A.nr.1186/2024

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar, me Ylber Fetahaj në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1186/2024 të datës 07.08.2024, të parashtruar nga ankuesi K.P, kundër organit të punësimit/Komuna e Dragashit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 57 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, në seancën e mbajtur me 17.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.1186/2024 e datës 07.08.2024, e parashtruar nga ankuesi K.P, **ndërsa mbetet në fuqi** Njoftimi për kandidatin fitues i datës 29.07.2024 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit .
- II. **Shfuqizohet** Vendimi A.nr.1186/2024 i datës 27.09.2024 dhe numër protokolli: 5159/2024, i Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

## A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, K.P (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 07.08.2024 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4109/2024, të regjistruar nën shenjën A.nr.1186/2024 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 04.07.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/Komuna e Dragashit, me të cilin njoftim ankuesit i është refuzuar aplikacioni për procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00014099, gjegjësisht për pozitën e punës *Specialist për Teknologji Zgjedhore* në Komunën e Dragashit.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.08.2024 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit, ndërsa kjo e fundit, më datë 22.08.2024, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për **vendosje meritore administroi këto prova**: Ankesën me numër protokolli 4109/2024 të parashtruar më datë 07.08.2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 04.07.2024 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit; kopjen e letërnjoftimit të ankuesit me numër 8261; Konkursin me numër reference RN00014099 të datës 23.05.2024; Diplomën e datës 10.01.2024 me Nr.2423 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për K.P; pasqyrën e trustit financiar për K.P; letër referencën e datës 08.03.2023 për K.P; Kërkesën për përgjigje ne ankesë të datës 21.08.2024; përgjigjen ne ankese të datës 27.08.2024; Aplikacionin e ankuesit K.P me date të aplikimit 09.06.2024; Vendimin e datës 03.07.2024 për themelimin e komisionit të pranimit; Akt Emërimit e datës 01.10.2018; Akt Emërimit e datës 03.11.2022; Akt Emërimit e datës 07.09.2021; Akt Emërimit e datës 29.11.2011; Akt Emërimit e datës 13.09.2021; Njoftimin për verifikim paraprak te datës 03.07.2024; Aplikacionin e aplikimit te kandidatit fitues V.R të datës 20.06.2024 me gjitha dokumentet e aplikimit; Testi me Shkrim i datës 27.07.2024 për V.R; Formularët e vlerësimit individual nga anëtarët e komisionit ne intervistës me goje te datës 26.07.2024; Njoftimin e datës 29.07.2024 për shpalljen e kandidatit fitues; Kërkesën e datës 27.09.2024 Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës te drejtuar Agjencisë për Parandalimit të Korrupsionit; Vendimin e datës 27.09.2024 të KPMSHCK-ës për Pezullimin e Procedurës; Njoftimin-Përgjigjen e datës 07.02.2024 nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit; Kërkese e datës 17.05.2024 për aprovimin e pozitës se lire; Përshkrimin e detyrave për pozitën Specialist për Teknologji Zgjedhorë; Rregulloren për Organizmin e Brendshëm , Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve te Punës në Komunën e Dragashit e datës 20.11.2024 Vendimin për Organizmin e Brendshëm te Administratës Komunale te Dragashit te muajt Shatorit 2023.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së Komuna e Dragashit, më datë 23.05.2024 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00014099, për Grupin e Shkencave të Inxhinierisë se Elektro-Teknologjisë, gjegjësisht për pozitën „*Specialist për Teknologji Zgjedhore*”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.05.2024 deri më datë 22.06.2024.

Rrjedhimisht, sipas provave materiale rezulton së në këtë konkurs kanë aplikuar pesë (5) kandidatë, në mesin edhe tyre edhe ankuesi të cilit sipas Njoftimit të datës 04.07.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të organit përkatës të punësimit, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara me shpalljen e konkursit përkatës, gjegjësisht diplomën e kualifikimit arsimor si dhe trustin pensional për dëshmimin e përvojë së punës tre vjeçare, ndërsa prej tyre kandidatëve vetëm një ka plotësuar kriteret e konkursit duke kaluar kështu fazën e verifikimit paraprak, i cili (V.R) duke qenë se ka marrë pjesë në të gjitha faza e rekrutimit sipas Njoftimit të datës 29.07.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, është shpallur kandidat fitues për pozitën përkatëse të punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se është eliminuar padrejtësisht nga procedura e rekrutimit duke bashkangjitur me këtë rast diplomën dhe pasqyrën e llogarisë së trustit pensional, rrjedhimisht ankuesi kërkon që të rifillohet procedura e aplikimit në mënyrë që të gjithë kandidatet të jenë të barabartë.

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se gjatë kohës së shqyrtimit të ankesës së ankuesit, përkatësisht afatit ligjor të vendimmarrjes, kishte pranuar kërkesë për monitorim të jashtëzakonshëm nga ana e dy Deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës A. A dhe A. R. të cilët kishin ngritur dyshimet për shkeljet në këtë procedure te pranimit dhe për mundësin e ekzistimit te konfliktit të interesit gjatë zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit që ndërlidhet me kandidatin fitues për këtë pozitë. Andaj me qëllim të eliminimit të kësaj situatë, Këshilli më date 27.09.2024 ishte drejtuar tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me kërkesën lidhur me ofrimin e opinionit për ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit në këtë procedurë të rekrutimit.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshilli duke u bazuar në rrethanat e krijuara dhe në mbështetje të nenit 85 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.118/2024 të datës 27.09.2024, kishte vendosur për pezullimin e procedurës lidhur me ankesën e datës 07.08.2024, të parashtruar nga ankuesi, deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përkatësisht deri në njoftimin zyrtarë që i bëhet Këshillit nga kjo e fundit.

Ndërsa, me datë 07.02.2025 Këshilli, ka pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit Përgjigjen me numër reference APK-DPKI-06-1396/24 të datës 06.02.2025, të protokolluar me numër 147/25 dhe datë 07.02.2025, lidhur me kërkesën për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit ku përmes kësaj shkrese Agjencia, njofton si në vijim, citoj:

- Vështruar nga aspekti administrativ i rregullimit dhe përcaktimit, me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm*.

Kështu, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare ”*.

... lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilën është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilën ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,* si dhe me nën paragrafin 1.12 të këtij neni. i cili e definon nocionin vendimmarrje si: *“çasti i fundit procesit vendimmarrës gjatë të cilën vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik. ”*

Në kuptim të dispozitave si më lartë. lidhur me vendimmarrjen eventuale të V.R në procesin e rekrutimit për pozitën *"Specialist për Teknologji Zgjedhore"*, Agjencia ka shqyrtuar dokumentacionin e siguruar nga Komuna e Dragashit, sipas të cilit dokumentacion V.R nuk figuron që të ketë marrë pjesë në këtë proces të rekrutimit nga pozita e Drejtorit të Administratës. Sipas shkresave të lëndës, kërkesa për fillimin e rekrutimit për pozitën e *"Specialistit për Teknologji Zgjedhore"*, është bërë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kadastrit- Sektori i Urbanizmit, për shkak të pensionimit të zyrtarit të mëhershëm (Nr. 111/01-

11378/24 e datës 17.05.2024). Pastaj, vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues është nxjerr nga kryetari i komunës, i cili komision përmes deklaratës me shkrim (11.10.2024), kanë deklaruar se: *"se gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën e lartë cekur, nuk kemi pasur asnjë presion, ndikim ose ndonjë formë të ngjashme të ndërhyrjes në procesin e rekrutimit"*, kurse Njoftimi RN00014099 i datës 29.07.2024 për listën përfundimtare të kandidatit fitues është nxjerrë nga NJBNJ-Dragash.

Me qëllim të sqarimeve të hollësishëm, Agjencia ka kërkuar dokumentacion shtesë nga Komuna e Dragashit, të cilin dokumentacion e kemi pranuar përmes shkresës zyrtare DPKI-06-133/25/25.

Ndër sqarimet e dhëna nga Komuna e Dragashit sipas kërkesës së Agjencisë, theksohet çështja e kompensimit për punë jashtë orarit të anëtarëve të Komisionit Përzgjedhës për pozitën *"Specialist i Teknologjisë Zgjedhore"* gjatë kohës së zhvillimit të procesit rekrutues, kompensime këto të aprovuara nga Drejtori i Administratës V.R, i cili është përzgjedhur për këtë pozitë. Sipas përgjigjes së Komunës së Dragashit, *"Procedura e rekrutimit, d.m.th. testi me shkrim është mbajtur me dl.22/07/2024 dhe intervista është mbajtur me dt.26/07/2024, gjatë kësaj periudhe anëtarët e komisionit nuk kanë pasur vendim për punë jashtë orarit dhe nuk janë kompensuar për punë jashtë orarit."* Si dëshmi për këtë kanë bashkangjitur regjistrin e pagave përkatës për anëtarët e komisionit.

Pastaj, ne vazhden e sqarimeve sa i përket pretendimeve se drejtori i administratës ka përgatitur detyrat dhe përgjegjësit për pozitën *"Specialist i Teknologjisë Zgjedhore"* për të cilën pozitë ka aplikuar edhe vetë ku edhe është përzgjedhur. Komuna e Dragashit ka theksuar se *"Që lidhje me detyrat dhe përgjegjësit për pozitën Specialist i Teknologjisë Zgjedhore ju njoftojmë se detyrat dhe përgjegjësitë e punës i harton Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Njësia e Burimeve Njerëzore sipas nevojave të drejtorisë, dhe duke u bazuar në Rregulloren për Klasifikimit e Vendeve të Punës nr.6/24 shtojca 1/4 Përshkrimi i Përgjithshëm i Punës për klasën Specialist."* Gjithashtu në sqarim është theksuar se udhëheqësi i personelit është në varësi të Kryetari të Komunës dhe i raporton të njëjtit.

Tutje, Komuna e Dragashit sqaron se, *"Testi mbahet në DMZP në Prishtinë, pyetjet e testit një shkruhen si për çdo pozitë, ashtu edhe për pozitën Specialist i Teknologjisë Zgjedhore i përpilon komisioni i caktuar për Zhvillimin e Procedurës së Rekrutimit duke u bazuar në Rregulloren nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbenin Civil neni 9 par.6 i kësaj Rregullore. Pyetjet e intervistës janë kompetence e secilit anëtar të komisionit, ata sipas bindjes se tyre i përpilojnë dhe i parashirojnë kandidatëve gjatë intervistës."*

Sa i përket përcaktimit të pozitës *"Specialist i Teknologjisë Zgjedhore"*, me rregullativën e brendshme ligjore të Komunës së Dragashit, të njëjtit kanë sqaruar se, *"Rregullorja për Organizimin e Brendshëm në K. Dragash është në fazën përfundimtare të hartimit, meqenëse është ndryshuar Ligji për Zyrtarët Publik dhe Rregullorja për Klasifikimin e Vendeve të Punës."* Lidhur me këtë kanë bashkangjitur tabelën për klasifikimin e vendeve të punës e cila është bazë për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Komunës së Dragashit.

Ndërsa, lidhur me kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike të përcaktuara me nenin 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të njëjtat vlejnjë vetëm për pozitë udhëheqëse apo menaxhuese të cilat kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me

mbikëqyrjen apo kontrollin e tyre nga pozita e zyrtarit të lartë publik (në rastin konkret të drejtorit të administratës).

Andaj, edhe pse rasti në fjalë në dukje mund të perceptohet si shkelje e mundshme, megjithatë pas vlerësimit të së njëjtit nga Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, nuk ka rezultuar me shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë konfliktin e interesit sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë fillimisht përgjigjen e datës 07.02.2025, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore e duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit për Grupin e Shkencave të Inxhinierisë së Elektro-Teknologjisë për pozitën „*Specialist për Teknologji Zgjedhore*” në Komunën e Dragashit, dhe si rrjedhojë nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit me numër të referencës RN00014099, ka konstatuar së për këtë pozitë të punës sipas pikës 3, tek kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e Arsimit të lartë e nivelit të parë(Bachelor): Elektrike dhe Kompjuterike, drejtimet Automatik ,Elektronik; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale ne fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lirë të punës e dëshmuar me trust.**

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohej se: **1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkua për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj**”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: **2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion, ndërsa referuar konkursit me numër reference RN00014990, gjegjësisht në pikën 5 të konkursit janë paraparë dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit si ne vijim : Kopjen e letërnjoftimit; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjet e dëshmisë së punësimit lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë (vërtetim/kontratë); Dëshmisë se punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet se paku njëra nga dëshmitë si ne vijim:; pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensional apo pasqyra e pagesave se obligimeve tatimore ne përputhje me legjislacionin tatimor për te ardhurat personale etj...**

Andaj, Kolegji i Këshillit, referuar gjetjeve si më sipër konstaton se të gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar se cilat dokumentet duhet të dorëzohen me rastin e aplikimit për konkursin përkatës, ndërsa nga analizimi dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi me rastin e aplikimit sa i përket plotësimin të kriterit të përvojës së punës, ka dorëzuar Letër Referencën e datës 08.03.2023 të lëshuar nga SH.P.K. “Renelual Tahiri”, nga i cili dokument i lëshuar nga Menaxheri Gjeneral i kësaj ndërmarrje private, deklarohet se ankuesi ka qenë i angazhuar për kryerjen e punëve në pozitën Operator i Hidrocentralit në HC Orqusha në Dragash, dhe atë nga data 01.04.2019 deri me datë 01.07.2022. Mirëpo ankuesi për këtë përvojë pune në sektorin privat, rezulton se nuk ka bashkangjitur së paku një të dhënë nga dëshmitë e kërkuara si më lartë apo thënë më konkretisht pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensional apo pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.

Tutje nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi me rastin e aplikimit të datës 09.06.2024, lidhur me plotësimin e kualifikimit arsimor nuk ka ofruar dëshminë përkatëse apo diplomën universitare për përfundimin e studimeve themelore siç edhe është pasqyruar më sipër se ka qenë i njoftuar se është kërkuar me shpalljen e konkursit të datës 23.05.2024, ndërsa ka bashkangjitur Letërnjoftimin (njërën anë) dhe Certifikatën mbi Aftësimin Profesional me Nr.097/22 të datës 13.04.2022, të lëshuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar kursin Elektronike industriale dhe IT.

Ndërsa, ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës të datës 07.08.2024 në Këshill, ka bashkangjitur Diplomën me Nr. 2423 të datës 10.01.2024, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, përmes së cilit dokument dëshmohet se ankuesi më datë 26.12.2023 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë, përkatësisht në Programin e Elektroenergjetikës duke fituar kështu titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike; Letër Referencën e njëjtë sikurse më sipër dhe Pasqyrën e trustit pensional për periudhën 01.08.2002 deri me 15.07.2024, si dhe Letërnjoftimin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme ( dy anët).

Mirëpo, është fakt i pa kontestueshëm se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë se këto dy dokumente të bashkangjitura në ankesën e parashtruar në Këshill, kanë qenë pjesë e aplikacionit të tij të datës 09.06.2024, për aplikim në procedurën e rekrutimit lidhur me përzgjedhjen e një kandidati për pozitën e punës *Specialist për Teknologji Zgjedhore* në Komunën e Dragashit, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ngase e njëjta gjendje faktike është vërtetuar nga dokumentacioni i ofruar nga organi punësimit me rastin e ofrimit të përgjigjes në ankesë dhe po ashtu kjo është vërtetuar edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, se asnjëri nga këto dy dokumente të bashkangjitura me ankesë nuk kanë qenë pjesë e aplikacionit, sepse në bazë të emalit të datës 27.09.2024 të dërguar nga Zyrtarja e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtaresve Publike (DMZP) Znj. F.Z, thekson si në vijim se, citoj: *“Kandidati K.P ka të plotësuar vetëm një përvojë pune 04/2019 - 07/2022 Renelual Tahiri, një Trajnim 12/2021-04/2022 Qendra për Aftësim Profesional, dhe Karta e Identitetit vetëm pjesa e parë”*.

Andaj, Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë gjendjen faktike të vërtetuar si më sipër, konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit, me Njoftimin e datës 04.07.2024, mbi të cilin ankuesit i ka refuzuar aplikacionin ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: 7. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve; 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa*

*vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi, ndërlidhur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe 1.7 të këtij Ligji, ngase i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;*

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me aktin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtruar procedurave të tjera të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike, mirëpo pavarësisht kësaj në rastin konkret ku edhe është kërkuar që kandidatët të kenë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës e dëshmuar me trust, rezulton se ankuesi edhe nëse do të dorëzonte dokumentet të cilat i ka bashkangjitur në ankesën e datës 07.08.2024, faktikisht përsëri nuk do të plotësonte kriterin e përvojës së punës sepse i njëjti ka diplomuar më datë 26.12.2023, ndërsa me datë 09.06.2024 ka aplikuar në konkursin përkatës, rrjedhimisht ankuesi deri më datën e aplikimit ka poseduar vetëm 5 muaj e 14 ditë përvojë pune, ngase përvoja e punës profesionale llogaritet pas diplomimit gjegjësisht pas përfundimit të studimeve themelore.

Kolegji i Këshillit, bazuar në Përgjigjen e datës 07.02.2025, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe shkresave të lëndës respektivisht dokumenteve të ofruara përmes emailit të datës 24.02.2025 nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, ka shqyrtuar në tersi procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe ka gjetur se inicimi i saj është realizuar nga Drejtori i Drejtoratit të Urbanizmit dhe Kadastrit- Sektori i Urbanizmit, me arsyetimin se pozita është e lire për shkak të pensionimit të zyrtarit të mëhershëm, ndërsa përshkrimi i vendit të punës është miratuar nga drejtuesi më i lartë i institucionit në këtë rast nga Kryetari i Komunës së Dragashit gjegjësisht pozita e lartpërmendur në bazë të provave materiale është parapare edhe me Rregulloren për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale të Komunës së Dragashit e miratuar në shtator të vitit 2023. Kolegji i Këshillit po ashtu në bazë të shkresave të lëndës konstaton se themelimi i Komisionit për vlerësimin e kandidatëve, është bere në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe se nuk evidentohet ndonjë shkelje esenciale ligjore në fazën e vlerësimit profesional.

Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedurë po ashtu bazuar në shkresat e lëndës ka shqyrtuar edhe aplikacionin e kandidatit fitues, nga analizimi i së cilit ka gjetur se i njëjti në dosjen e tij personale të dorëzuar më rastin e aplikimit në konkursin përkatës sa i përket plotësimit të kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me numër Nr. 1628 të datës 22.05.2019, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes së cilës dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë me datë 16.05.2019 në Drejtimin Elektrike dhe ka fituar titullin Bachelor i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, ndërsa lidhur me dëshmimin e përvojës së punës i njëjti rezulton se posedon Vërtetimin e lëshuar nga Komuna e Dragashit, përmes së cilit dokument zyrtar dëshmohet se nga data 30.12.2021 deri më datë 31.07.2024, ka qenë i punësuar në organet e administratës së Komunës të Dragashit; Letër referencën e datës 22.03.2021 të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit, mbi të cilin dokument dëshmohet se kandidati në fjalë nga muaji qershor 2020 deri në muajin mars 2021 ka qenë i angazhuar në cilësinë e asistentit administrativ pranë këtij organi të punësimit, po ashtu i njëjti këtë përvojë pune e ka mbështetur edhe me Pasqyrën e trustit pensional, rrjedhimisht duke vërtetuar se ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara me shpalljen e konkursit të cilat edhe janë pasqyruar si më sipër.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ne baze të vlerësimit Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse refuzimin e aplikacionit të ankuesit dhe shpalljen e Njoftimit të datës 29.07.2024 për kandidatin fitues për pozitën e punës *Specialist për Teknologji Zgjedhore*, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimi i datës 29.07.2024 për kandidatin fitues për pozitën e punës *Specialist për Teknologji Zgjedhore* në Komunën e Dragashit, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1186/2024.**

**Ylber Fetahaj**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit K.P;*
- *Udhëheqësit së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*